



Takimi i 103-të Plenar

13 mars 2025, Takim në distancë

I. Miratimi i procesverbalit dhe i rendit të ditës, Informacion i dhënë nga Kryetarja

I.1. Procesverbali i takimit të 102-të Plenar – miratim

Procesverbali i takimit të mëparshëm u miratua unanimisht me ndryshimet e dakorduara. Anëtarët e EDPB-së ranë gjithashtu dakord për versionin publik të procesverbalit.

I.2. Rendi i ditës i projekt-takimit të 103-të të EDPB – miratim

Rendi i ditës u miratua me përfshirjen e një pike shtesë në AOB (pika D3.3).

Diskutimet lidhur me pikat e rendit të ditës D.3.1 u shpallën konfidenciale sipas nenit 33 të Rregullores së Punës të EDPB-së.

A. Pikat e rendit të ditës për miratim

Nuk pati kërkesë për të diskutuar pikën A, e cila u miratua unanimisht:

- Opinioni mbi vendimin draft të SE SA lidhur me BCR-C të Grupit Alfa Laval.

B. Pikat e rendit të ditës për diskutim

B.1. Pika të rendit të ditës për diskutim në prag miratimi

B.1.1. Deklaratë mbi zbatimin e Direktivës PNR në dritën e vendimit të Gjykatës së Drejtësisë C-817/19 (Kufijtë, Udhëtimet & Zbatimi i Ligjit)

Kryetarja e EDPB-së rikujtoi sfondin e këtij dosjeje dhe deklaratën e mëparshme të EDPB-së mbi zbatimin e Direktivës PNR në dritën e vendimit të Gjykatës së Drejtësisë (C-817/19), e cila u miratua në dhjetor 2022. Ajo falënderoi anëtarët e nën-grupit të ekspertëve për Kufijtë, Udhëtimet dhe Zbatimin e Ligjit, veçanërisht anëtarët e ekipit hartues, dhe më pas i dha fjalën raportuesit kryesor. Raportuesi shpjegoi se kjo deklaratë e dytë trajton fushat ku nevojiten udhëzime shtesë, për gjashtë tema: kategoritë e personave, lidhja objektive, fluturimet brenda BE-së, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe përpunimi i automatizuar, rishikimi i pavarur paraprak dhe periudha e ruajtjes së të

dhënave.

Deklarata u miratua unanimitet nga anëtarët e EDPB-së.

B.1.2. Dokument i EDPB-së që përcakton procedurën për miratimin e “Rregullave Korporative të Detyrueshme” për kontrolluesit dhe përpunuesit sipas GDPR (ESG Transferimet Ndërkombëtare)

Kryetarja shpjegoi se, nëse miratohet, ky dokument do të zëvendësojë dokumentin e përgatitur nga Grupi i Punës i Nenit 29 (WP263 rev.01), i miratuar nga EDPB në vitin 2018, dhe do të publikohet në faqen zyrtare. Raportuesi kryesor shpjegoi se procedura e përditësuar synon shkurtimin e kohës së miratimit dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes autoriteteve mbikëqyrëse. Dokumenti u miratua unanimitet.

B.2. Pika të rendit të ditës për diskutim

B.2.1. Raporti vjetor mbi përdorimin e ekspertëve të jashtëm

Sekretariati i EDPB-së prezantoi raportin që përmbledh aktivitetet e kryera gjatë vitit 2024 brenda projektit të Pool-it të Ekspertëve Mbështetës (SPE). Sekretariati i EDPB-së shpjegoi se 17 projekte ishin përfunduar në fund të vitit 2024, dhe 9 projekte u nisën gjatë vitit 2024. Sekretariati i EDPB-së inkurajoi anëtarët e EDPB-së të vazhdojnë të përdorin produktet brenda strukturës së tyre kombëtare, si dhe të propozojnë projekte të reja, të cilat mund të jenë për mbështetje të autoritetit kombëtar ose në kontekstin e aktiviteteve me një nën-grup ekspertësh të EDPB-së, duke theksuar se ende është e mundur të propozohen projekte për vitin 2025.

Raporti publik mbi përdorimin e ekspertëve të jashtëm do të jetë i disponueshëm në faqen zyrtare të EDPB-së. Së fundmi, Sekretariati i EDPB-së propozoi, duke marrë parasysh suksesin dhe nivelin e pjekurisë së projektit, që të mos konsiderohet më si pilot. Kjo u pranua nga anëtarët e EDPB-së.

Disa anëtarë të EDPB-së ndërhynë për të shprehur falënderimet për punën e bërë dhe theksuan dobishmërinë e këtij instrumenti. Disa anëtarë ndanë informacione për projekte që janë në proces nisjeje.

Një anëtar i EDPB-së rikujtoi se qëllimi fillestar i projektit SPE ishte të ofronte mbështetje për hetimet dhe veprimet e zbatimit të ligjit. Në këtë drejtim, Sekretariati i EDPB-së rikujtoi veprimet e përfunduara dhe ato që janë në vazhdim.

Sekretariati i EDPB-së falënderoi anëtarët për reagimet pozitive, dhe informoi se lista e ekspertëve të SPE do të skadojë në fillim të vitit të ardhshëm dhe se do të hapet një thirrje e re për ekspertë.

Anëtarët e EDPB-së morën në dijeni informacionin e dhënë.

C. Çështje organizative

C.1. Ekipi i Reagimit të Shpejtë i EDPB-së

Kryetarja e EDPB-së rikujtoi diskutimin në mbledhjen e fundit plenare, ku u vendos të krijohet një ekip i reagimit të shpejtë (QRT) për të koordinuar mes autoriteteve mbikëqyrëse në rastet kur shfaqen çështje urgjente dhe të ndjeshme. Më pas, kryetarja edha fjalën njërit prej raportuesve për të paraqitur propozimin.

Raportuesi shpjegoi se qëllimi i QRT-së është që anëtarët të mund të komunikojnë shpejt mes tyre në skenarët e përmendur nga kryetarja e EDPB-së, në mënyrë që të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të paraqiten të bashkuar. Ai theksoi se, edhe pse disa raste specifike nxitën idenë për QRT-në, ky ekip nuk është menduar të merret me përmbajtjen e këtyre çështjeve të veçanta. Raportuesi më pas prezantoi dy pikat e diskutimit lidhur me nivelin e përfaqësimit, si dhe mënyrën e komunikimit.

Disa anëtarë të EDPB-së mbështetën nismën dhe theksuan rëndësinë e komunikimit të hershëm për

të siguruar koherencë në veprimet e autoriteteve mbikëqyrëse. Një autoritet mbikëqyrës kujtoi se QRT-ja nuk synon të zëvendësojë mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit brenda EDPB-së, dhe se do të ishte e dobishme të përcaktohej qartë kur duhet përdorur QRT-ja dhe kur kanalet e tjera ekzistuese të EDPB-së.

Raportuesi gjithashtu theksoi se nuk është synimi që autoritetet mbikëqyrëse të ndërpresin procedurat e tyre kombëtare për të informuar QRT-në, por që kjo mund të bëhet paralelisht.

Anëtarët e EDPB-së ranë dakord të krijojnë QRT-në sipas propozimit dhe që përfaqësimi i saktë në QRT të përcaktohet nga secili autoritet dhe të kufizohet në dy persona. Sa i përket formës së komunikimit, shumica e anëtarëve të EDPB-së ishin në favor të përdorimit të një aplikacioni mesazhesh, ndoshta i kombinuar me email. Forma e saktë e komunikimit do të përcaktohet pas një vlerësimi nga DPO-ja.

Anëtarët e EDPB-së ranë dakord që iniciativa QRT të ketë një fazë pilot prej 6 muajsh, pas së cilës do të diskutohet sërish.

C.2. Kërkesa për mandat të Grupit të Punës për Zbatimin e Inteligjencës Artificiale (dikur Grupi i Punës ChatGPT)

Kryetarja e EDPB-së rikujtoi diskutimin në mbledhjen plenare të fundit, ku u vendos të përgatitej një mandat i zgjeruar për grupin e punës ChatGPT. Më pas, ai i dha fjalën koordinatorit të grupit të punës për të përshkruar rrugën e sugjeruar përpara.

Koordinatori i grupit të punës ChatGPT shpjegoi se shkëmbimet brenda grupit duhet të fokusohen në rastet kur kontrolluesit nuk kanë seli në BE/EEA, pra në rastet që janë jashtë mekanizmit One Stop Shop. Grupi i punës, në të ardhmen, do të përgatisë një raport mbi punën e tij, siç është bërë edhe më parë për raste të tjera. Emri i ri i propozuar për grupin e punës është “Grupi i Punës për Zbatimin e Inteligjencës Gjeneruese”.

Një anëtar i EDPB-së sugjeroi që të modifikohej pak formulimi në pikën B të draft mandatit, që të lexojë “inteligjencë gjeneruese”. Nuk pati kundërshtime ndaj këtij propozimi.

Anëtarët e EDPB-së ranë dakord të miratojnë mandatin me ndryshimin e propozuar.

C.3. Identiteti vizual i EDPB-së

Sekretariati i EDPB-së ndau një përditësim lidhur me rifreskimin e identitetit vizual të EDPB-së, i cili përfshin një logo të përditësuar dhe një slogan të ri. Qëllimi i këtij rifreskimi është të krijohet një identitet vizual më i dallueshëm dhe më tërheqës, si dhe të sigurohet konsistencë në të gjitha platformat. Ky ndryshim do të zbatohet gradualisht gjatë muajve në vijim.

Anëtarët e EDPB-së u njohën me informacionin e dhënë.

D. Pikat e rendit të ditës për informacion

D.3. Çështje të tjera

D.3.1. “Veprimi presidencial i SHBA-së mbi Mbrojtjen e Kompanive dhe Inovatorëve Amerikanë nga Shantazhi dhe Gjobat e Padrejta nga Jashtë”

Kryetarja e EDPB-së rikujtoi anëtarët e EDPB-së për konfidencialitetin e diskutimeve.

Një anëtar i EDPB-së iu referua memorandumit amerikan “Veprimi presidencial mbi Mbrojtjen e Kompanive dhe Inovatorëve Amerikanë nga Shantazhi dhe Gjobat e Padrejta nga Jashtë”, të datës 21 shkurt 2025 dhe të publikuar në faqen zyrtare të Shtëpisë së Bardhë. Anëtarët e EDPB-së u njohën me informacionin e dhënë.

D.3.2. Zhvillimet e fundit lidhur me dezinformimin në platformat e rrjeteve sociale

Një anëtar i EDPB-së ngriti çështjen se disa platforma online kanë vendosur të ndalojnë verifikimin e fakteve për përmbajtjen në platformat e tyre, duke shprehur shqetësime mbi pasojat e këtyre zhvillimeve dhe ndikimin e tyre në të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale. Disa anëtarë të EDPB-së ndërhyjnë për të shprehur shqetësimet e tyre. Një anëtar theksoi nevojën për një qasje ndër-rregullatore në këtë çështje. Ky anëtar përmendi gjithashtu mendimin e fundit të Avokatit të Përgjithshëm në çështjen C-492/23 në lidhje me detyrimin e platformave online. Lidhur me bashkëpunimin ndër-rregullator, Sekretariati i EDPB-së rikujtoi shkëmbimet e mëparshme me Rrjetin Evropian të Bashkëpunimit për Zgjedhjet dhe Autoritetin për Partitë Politike Evropiane dhe Fondacionet Politike Evropiane. Sekretariati i EDPB-së iu referua gjithashtu Rregullores 2024/900 për reklamimin politik, për të cilën EDPB duhet të punojë për udhëzime në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian.

D.3.3. Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (C-203/22)

Një anëtar i EDPB-së tërhoqi vëmendjen për këtë vendim të fundit dhe theksoi rëndësinë e tij, ku Gjykata dha një interpretim të nenit 15(1)(h) të GDPR për herë të parë. Gjykata gjithashtu vendosi se, nëse një kontrollues pretendon se ky informacion nuk mund t'i bëhet i ditur subjektit të të dhënave sepse është sekret tregtar, ai kontrollues është i detyruar të ndajë këtë informacion me Autoritetin Mbikëqyrës, i cili duhet të vendosë nëse ky është rasti.

Informacion përmbyllës

Kryetarja e EDPB-së rikujtoi anëtarët se në mbledhjen e ardhshme plenare do të diskutohet emërimi i koordinatorëve. Në këtë drejtim, Kryetarja e EDPB-së informoi anëtarët se ende nevojitet një kandidat për ENF ESG dhe CEH ESG. Kryetarja e EDPB-së i ftoi anëtarët të shqyrtojnë nëse autoriteti i tyre mbikëqyrës është në gjendje të propozojë një kandidat për këtë punë të rëndësishme.

Aneks: Lista e Pjesëmarrësve

AT SA, BE SA, BG SA, CY SA, CZ SA, DE SA, DK SA, EDPS, EE SA, EL SA, ES SA, FI SA, FR SA, HR SA, HU SA, IE SA, IS SA, IT SA, LI SA, LT SA, LU SA, MT SA, NL SA, NO SA, PL SA, PT SA, RO SA, SE SA, SI SA, SK SA

LV SA ia delegoi votën Autoritetit Mbikëqyrës të Estonisë.

Komisioni Evropian

Vëzhgues:

AL SA, GE SA, XK SA. Në përputhje me nenin 8 të Rregullores së Procedurave të EDPB-së, vëzhguesit ishin të pranishëm gjatë mbledhjes plenare për të gjitha pikat e agjendës.

- CH SA (Federale) ishte i pranishëm gjatë mbledhjes plenare për pikën B.1.1 të rendit të ditës. Sekretariati i EDPB-së